



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:104582

Datë: 28.02.2021

Numri i dokumentit: 01549111

C.nr.333/2018

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, me gjyqtaren Mirvete Alidemi dhe bashkëpuntoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, duke vendosur në çështjen juridike kontestuese të paditësve: R.M, M. M E. M, që të gjithë nga fshati Gllamë Komuna e Gjilanit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Vehbi Ismajli avokat nga Prishtina, kunder të paditurës K.S. ‘‘ PRISIG’’, me seli në Prishtinë, Rr. ‘‘Eduard Lir’’ të cilin e përfaqëson S. R me bazë juridike kompensim i dëmit material dhe jo material nga baza e autopërgjegjësisë, në shqyrtimin gjyqësor publik të mbajtur me datë 09.11.2020, ndërsa jashtë seancës gjyqësore më datën 04 Janar 2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.MIRATOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësve: R., M dhe E. M që të gjithë nga fshati ... Komuna e Gjilanit dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e sigurimeve K.S ‘‘ PRISIG’’, me seli në Prishtinë, që paditësve në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material t’ia paguaj shumat si në vijim:

Për paditësin R. M:

- në emër të dhimbjeve fizike shumen prej 1,450.00 euro
- në emër të përjetimit të frikës shumën prej 1,450.00 euro
- në emër të përkujdesjes dhe ndihmës së huaj shumën prej 420.00 euro
- në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 455.00euro

Gjithësej shumën prej 3.775.00 euro/cent.

Pjesa tjetër e kërkesëpadiisë në shumë prej 1,360.00 euro në emër të fitimit të humbur e kërkuar si në padi refuzohet si e pa bazuar.

Për paditësen M. M:

- në emër të dhimbjeve fizike shumen prej 1,250.00euro
- në emër të përjetimit të frikës shumën prej 1,250.00
- në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 330.00 euro
- harxhimet për kontrolla dhe barna shumen prej 41 euor.

Gjithësej shumën prej 2, 871.00 euro

Pjesa tjetër e kërkesëpadisë në shumë prej 500 euro për zhdëmtim të aftësisë për jetë, për fitimin e humbur dhe për përkujdesjen dhe ndihmën e huaj e kërkuar si në padi refuzohet si e pa bazuar.

-Për paditësin E.M :

- në emër të dhimbjeve fizike shumen prej 1, 350.00 euro
- në emër të përjetimit të frikës shumën prej 1,350.00 euro
- në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 255 euro.

Gjithësej shumën prej 2,955.00 euro. .

Ashtu që shuma e tërësishme e dëmit që duhet të paguaj e paditura për paditësit është 9,601.00 euro/cent, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data e marrjes të këtij aktgjykimi (3 Janar 2021) e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 2,440.00euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

II. REFUZOHET e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë në shumë prej 2,840.00 euro, për zhdëmtimin e aftësisë për jetë, fitimin e humbur dhe për përkujdesjen dhe ndihmën e huaj e kërkuar si në padi .

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësit në padin e paraqitur në këtë gjykatë më datën 28 Mars 2018, në shqyrtimit gjyqësor dhe në shpjegimet përfundimtare, ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditësve të miratohet në tërësi për të gjitha format e dëmit dhe në shumat e përcaktuara si në padi dhe në fjalën përfundimtare, ashtu që ta detyroj të paditurën që paditësve t'ia kompensoj dëmin që e kanë pësuar si pasoj e lëndimeve të marrura në aksidentin e komunikacionit të ndodhur më datën 18 Shkurt 2018 dhe atë: Për paditësin R. M, për dëmin material dhe jo material dhe atë: për dhimbjeve fizike shumen prej 1,450.00 euro, për përjetimit të frikës shumën prej 1,450.00euro, për zhdëmtimit të aftësisë për jetë shumën prej 980 euro, për fitimin e humbur shumën prej 380 euro, për përkujdesjen dhe ndihmën e huaj shumën prej 420 euro, për ushqim të përforcuar shumën prej 455euro, gjithesej shumen prej 5,135 euro. Për paditësen M.M, për dhimbje fizike shumen prej 1,250.00 euro, për përjetimin e frikës shumën prej 1,250.00 euro, për zhdëmtimit të aftësisë për jetë shumën prej 480 euro, për fitimin e humbur shumën prej 80 euro, për përkujdesje dhe ndihma e huaj shumën prej 340 euro, për ushqimit të përforcuar shumën prej 41 euro, shpenzime mjeksore shumën prej 41 euro, e gjitha në shumë të përgjithshme prej 3,371.00 euro. Për paditësin E.M për dhimbje fizike shumen prej 1,350.00euro, për përjetimin e frikës shumën prej 1,350.00 euro, për zhdëmtim të aftësisë për jetë shumën prej 480 euro, për fitimin e humbur shumën prej 280 euro, për përkujdesje dhe ndihma e huaj shumën prej 220 euro, për ushqimit të përforcuar shumën prej 255 euro, të gjitha shumën prej 3, 935.00euro. Ndërkaq në shqyrtim kryesor ka bërë precizmin e kërkesëpadisë për të gjitha format e dëmit e shkaktuar në shumën e përgjithshme prej 12,441.00€. Poashtu ka kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditura që të paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore me sa vijon: taksen gjyqësore në shumë prej 102€, për dy ekspertiza mjekësore shumën prej 300€, për përpilimin e padisë shumën prej 416€, në mbështetje të

numrit tarifor 6 të vlerës së kontestrit mbi 10.000.00€, për çdo seancë gjyqësore me nga 540.80€ e që shuman e përgjithshme është prej 1,622.40€ duke u bazuar në numrin tarifor 7 të shuma mbi 10.000€ të vlerës së kontestit e që shuman e përgjithshme e kërkuar është prej 2,440€, të gjitha në afat ligjor si në petitudin e aktgjykimit.

I autorizuari i të paditurës ka deklaruar që mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe kërkesëpadsisë, duke theksuar që nuk e kontestonë bazën juridike të padisë në kuptim të përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit, por e kontestonë lartësinë e saj dhe i ka propozuar gjykatës që me rastin e vendosjes të ketë parasysh edhe gaditshmërinë e tyre në procedurë administrative për kompensimin e dëmit për shumat e propozuar nga e paditura, duke u bazuar në lëndimet e pësuar të paditësve të cilat janë konstatuar nga ana e ekspertëve mjekësor dhe të cilat korrenspondojnë të njëjta me mendimet e ekspertëve të caktuar nga gjykata.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridiko civile në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: raporti i aksidentit me numër të rastit i datës 18.02.2018 dhe skica nga vendi i ngjarjes i përpiluar nga Policia e Gjilanit, Raporti i Emergjencës nga Spitali i Përgjithshëm në Gjilan nr.3826 i datës 18.02.2018, në emër R. M , ku përfshihet raporti i mjekut psikiatër me nr.i datës 21.02.2018, raporti i mjekut ortoped me nr. ... i dt. 22.02.2018, raporti i mjekut psikiatër me nr. ... i datës 08.03.2018, raporti i ortopedisë me nr. ... i dt. 22.03.2018, raporti i mjekut psikiatër nr. 1442 i datës 22.03.2018, certifikata e lindjes për të miturin R. M

Raporti i Emergjencës nga Spitali i Përgjithshëm në Gjilan nr....i dt. 18.02.2018, në emër M. M , ku përfshihet raporti i mjekut psikiatër me nr. ... i dt. 21.02.2018 dhe ... i datës 22.03.2018, raporti i mjekut të ortopedisë me nr... i dt. 22.03.2018 dhe ... i datës 22.02 2018 , ... i datës 08.03.2018, raporti i mjekut psikiatër me nr. ... i dt. 08.03.2018, dëftesa për pagim e participimit nr.... në emër të M. Me datës 22.03.2018 dhe 3 kupona fiskal të datave si në vijim: 01.03.2018, 02.03.2018 dhe 27.02.2018, deftesat e Spitalit Rajonal të Gjilanit të dt. 22.02.2018, 27.01.2018, 01.03.2018, 08.03.2018 dhe 22.08.2018. Raporti i Emergjencës nga Spitali i Përgjithshëm në Gjilan nr. ... i dt. 18.02.2018 në emër të E. M, ku përfshihet raporti i mjekut psikiatër me nr. ... i dt.08.03.2018, raporti i mjekut ortoped me nr.... i dt.08.03.2018, raporti i mjekut psikiatër me nr. ... i datës 21.02.2018, raporti i ortopedisë me nr. ...i dt. 22.03.2018, raporti mjekut psikiatër nr. ... i dt.22.03.2018 dhe raporti i ortopedisë numer 2248 i dates 22.05.2018.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në mbështetje të dispozitave të nenit 8 të LPK-ës, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykim nga këto arsye:

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadsisë , mirëpo kontestuese ishte lartësia e sajë, meqë i autorizuari i palës së paditur ka deklaruar se i kishin prezentuar oferten si ne vijim : Për paditesin R. M shumen prej 550.70€, për paditesen M. M shumen prej 510€ si dhe për paditesin E. M shumen e njëjtë, me të cilën shumë paditësit nuk ishin pajtuar.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadsisë , gjykata sipas propozimit të të autorizuarit të paditësve , në cilësinë e provës materiale ka nxjerrë ekspertizën e mjekësore të punuar nga Dr. Rrahman Hajdari, ekspert i ortopedisë dhe Dr. Afrim Cana , ekspert i psikiatrisë, të cilët në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësve , kanë dhënë mendimin profesional, përmes ekspertizave të punuara me shkrim më datën 28.02.2020 ekspertiza ortopedike dhe më datën 06.02.2020 ekspertiza psikiatrike. Sipas ekspertizës

ortopedike paditësit kanë pësuar lëndime me sa vijon: Paditësi R.M ka pësuar lëndim të lehtë trupor që është manifestuar me dhembje fizike të intensitetit të lartë 30 min, intensitetit të mesëm 1 muaj dhe intensitetit të ulët 1 muaj, pastaj ka konsultuar që zvoglim të përherhshëm të aktivitetit jetësor nuk ka pasur por ka pasur nevojë për përkujdes dhe ndihma nga pësoni i tretë, për ushqimi të përforcuar për 15 ditë dhe terapia fizikale 15 ditë. Paditësja M. M ka pësuar lëndim të lehtë trupor që është manifestuar me dhimbje fizike të intensitetit të lartë prej 30 min, intensitetit mesatarisht të mesëm një muaj dhe intensitetit mesatarisht të lehta një muaj, ushqim të përforcuar 10 ditë dhe terapi fizikale 15 ditë (në kuptim të relaksimit të muskujve). Paditësi E. M, ka pësuar lëndime të lehta trupore që është manifestuar me dhimbje fizike të intensitetit të lartë 30 minuta, intensitetit të mesëm një muaj intensitetit të lehtë një muaj, ushqimi i përforcuar 10 ditë dhe terapia fizikale 15 ditë.

Ndërkaq sipas ekspertizën mjekësore të punuara nga Dr.Afrim Cana ekspert i psikiatrisë, i cili në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësve, ka dhënë mendimin profesional përmes ekspertizës së punuar me shkrim të datës 06.02.2020 dhe ka konstatuar që R. M i është ekspozuar një situatë në të cilën është ndier i kërcnuar për gjendjen e tij shëndetsore dhe te ai është manifestuar: frikë primare e intensitet të lartë ka që ka zgjatur 1 minutë, frikë sekondare 2 muaj. Paditësja M. M ka pasur frikë primare në kohëzgjatje prej 1 minutë, frikë sekondare për intervalin kohor prej 2 muajsh , ndersa E.M., frikë primare ka pas 1 minutë dhe frikë sekondare 2 muaj, po ashtu eksperti në fjalë është dëgjuar edhe në seancën kryesore të dt. 09.11.2020, ku mes tjerash ka theksuar se meqë të tre personat e lënduar kanë qenë udhëtar, përjetimin e frikës primare e kanë pas në të njëjtën kohë dhe kjo frikë mund të jetë me intensitet të njëjtë, ndersa sa i përket frikës sekondare e njëjta specifikohet si frikë duke u bazuar në raportet mjekësore dhe që ka vërejtur kohëzgjatjen prej 2 muajve.

Me këto prova të administruara gjykata në emër të dhimbjeve fizike i miratoi kërkesat e paditësve në shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe e vlersoi si një shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit , sepse të gjithë paditësit sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortopedik, si pasojë e lëndimeve të marra , kanë pësuar dhembje fizike të intensitetit të lartë 30 minuta, intensitetit të mesëm një muaj dhe intensitetit të ulët një muaj Ndërkaq për përkujdes dhe ndihmë nga pësoni i tretë ka pasur nevojë vetëm paditësi i parë R. M , ndërsa për ushqim të përforcuar prej 15 ditësh dhe terapi fizikale për 15 ditësh kanë pasur nevojë të gjithë paditësit për të cilat kërkesa gjykata i miratoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në emër të frikës së përjetuar gjykata ka caktuar shpërblimin në shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për secilin paditës veq e veq , dhe ka vlerësuar si shpërblime të drejta , duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertit mjekësor të psikiatrisë, të gjithë paditësit kanë pësuar frikë primare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej (1) minuti që konsiderohet që përjetohet si emocion gjatë shfaqjes (manifestimit) të fatkeqsive në trafik, apo lëndimeve në vendin e punës, por edhe pas momentit të lëndimit të pësuar sikur edhe pas fatkeqësisë dhe kështu ajo interpretohet si një përgjegjësi afektive ndaj rrezikut direkt dhe frikë sekondare karakterisika e e të cilës është edhe mundësia që ajo të ketë ndikim direkt në prishjen apo dëmtimin e baraspeshës psikike të intervalit afatgjatë të individit , sikur që duket të ketë ndodhur në rastin konkret pasi që paditësit kanë vazhduar me konsultime psikiatrike.

Kërkesën e të autorizuarit të paditësve të paraqitur në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, për zhdëmtim të aftësisë për jetë dhe për fitimin e humbur gjykata i refuzoi si të pa bazuar meqë kërkesat e tillë nuk janë vërtetuar me asnjë provë të deponuar në shkresat e lëndës e as në ekspertizat e ekspertëve përkatës. Ndërsa kërkesa për shpenzimet e bëra për kontrollimet

mjekstore dhe barnat janë vërtetuar me provat që gjenden në shkrsat e lëndës të cilat gjykat i miratoi.

Gjykata ia fali besimin e plotë raporteve mjekësore të administruara të lëshuara nga Emergjenca e Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan për secilin paditës, ngase këto raporte janë përdor edhe nga ana e ekspertëve lidhur me konstatimin e lëndimeve si dhe friken e përjetuar.

Ekspertizat të lartpërmendura gjykata i mori në tërësi të bazuara dhe ia dhe besimin e plotë, këtë ngase ekspertizat përmbajnë elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerëson si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata vlerësoi që e paditura mbanë përgjegjësi në bazë të fajit për dëmin e shkaktuar paditësve me rastin e lëndimit gjatë aksidentit të trafikut , për çka e paditura është e detyruar që paditësve t'ia kompensoj dëmin meqë shkaktuesi i dëmit ka lidhur kontratë me të paditurën KS "Prisig" në Pristinë dhe në këto rrethana kompensimin e dëmit e bën e paditura mbi bazën e sigurimit të auto përgjegjësive TPL(Sigurimit të detyrueshëm për palët e treta) në mbështetje të nenit 178 al.1 dhe 154 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e detyrimeve.

Me dispozitën e nenit 202 al. 1 e LMD-se janë parashikuar llojet apo format e shpërblimit të dëmit jo material dhe atë për dhimbjet e pësuar fizike, për frikën e pësuar etj.

Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jo material, e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditësit, moshën e tij, në bazë të vlerësimit të ekspertizave mjekësore të përshkruar si më lartë, gjykata miratohet të kërkesëpadinë e paditësve e në vlerat e shpërblimit të dëmit si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, duke vlerësuar si shpërblim real, objektive dhe me bindje se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e lëndimeve.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me dëmin jo material gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë.

Gjykata vendosi që t'i refuzoj kërkesat e paditësve, në shumën prej 2,840.00 euro, për zhdëmtimin e aftësisë për jetë, fitimin e humbur dhe për perkujdesjen dhe ndihmën e huaj e kërkuar si në padi për të gjithë paditësit , pasi që vlerësoi se nga ana e palëve paditëse dhe nga ekspertët, gjykatës nuk i është ofruar asnjë provë bindëse me të cilën kishte me u vërtetuar lartësia e kërkesave të pretenduar. Andaj në mungesë të dëshmive për dëmin material gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit për pjesën e refuzuar.

Gjykata konsideron se shumat e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraqesin një satisfaksion moral dhe shpagim real për format e dëmeve të pësuar të paditësve në aksidentin e komunikacionit, lëndimit dhe pasojave duke marrë parasysh edhe kriteret e parapara me dispozitën e nenit 200 te Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve, standardin jetësor të qytetareve të Kosovës dhe praktiken e deritanishme të Gjykatave të Kosovës.

Gjykata lidhur me kërkesën për kamatën ka vendosur në mbështetje të nenit 277 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u bazuan në dispozitat e neneve 449 dhe 452.1 të LPK-se, si dhe në tarifën e avokatëve të Kosovës ashtu që është detyruar e paditura t'ia paguaj të autorizuarit të paditëses , për përpilimin e padisë 416 euro, për taksën gjyqësore 102 euro, për shpenzimet për ekspertiza gjyqësore shumë prej 300 euro, për tri shqyrtime gjyqësore të mbajtuar shumë me nga 540.80euro (1,622.40 euro), e që gjithësejt shpenzimet gjyqësore në shumë prej 2,440.00euro.

Mbi bazën e të lartshënuarave u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C. nr.333 -2018, më datën 4 Janar 2021

Gjyqtarja,
Mirvete Alidemi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:104582
Datë: 28.02.2021
Numri i dokumentit: 01549111